

KDU 342.2(496.51)

KDU 327(496.51)

Sfida poststatusore e Kosovës – sfidë e ndërtimit të kapaciteteve diplomatike

Fadil Maloku

Kosovën me aktin e shpalljes së pavarësisë për një republikë parlamentare, në fakt përveç shumë sfidave dhe problemeve tjera të natyrës para së gjithash: të **sigurisë** që këtyre ditëve po testohet me një intensitet tejet domethënës do të thosha, në periudhën që po hyjmë e presin edhe ato **ekonomike** (*varfëria e skajshme që dita ditës po rritet*), **sociale** (*papunësia ekstreme*), **juridike** (*përfundimi dhe procedimi i ligjeve dhe Kushtetutës në Parlamentin e Kosovës*) pastaj ato **politike**, (*ndërtimi i institucioneve të plota demokratike në kolizion me standardet Evropiane*) etj . por në veçanti dhe në mënyrë urgjente do theksoja Kosovën aktualisht e pret çështja e kapaciteteve dhe infrastrukturës së re diplomatike që do të fuqizohet me ministrinë e re të Punëve të Jashtme. Që për mendimin tim do të duhej domosdoshmërisht të

Fadil Maloku, Dr. *Ligjërues i lëndës Sociologji Politike.*

shoqërohej edhe me një procedurë inkurajuese në kuptimin e procedimit të një lloj apo tipi të "seleksionimit" të brendshëm elitik, në mënyrë Kosova sa më denjësisht jo vetëm të përfaqësohet por edhe të artikulohet dëshmia që sot në gjuhën e politikës trendëve globalizues shquhet si standard i përfaqësimit diplomatik.

Në këtë kontekst, meqë Kosova si shteti më i ri më në fund ia arriti të zë trenin e fundit të rrumbullakimit të synimit të sajë për një pak a shumë shtet normal (por kisha me thënë jo edhe tërësisht "sovran" dhe "i pavarur" ashtu siç ka filluar të përdoret në vokabularin tonë politik, për shumë arsye që tani nuk janë objekt i fokusimit tonë në këtë debat), sikurse gjitha shtetet për rreth neve, është e nevojshme që të ketë stafin e vetë të përfaqësimit diplomatik. Meqë, ne si shoqëri që kemi dalë prej një krahore të luftës dhe një zero jo përvoje të përfaqësimit të interesave tona kombëtare nëpër botë, gjykojë

që Qeveria e Z. Thaçi përkundër të gjitha atyre sakrificave morale, politike e ushtarake është e nevojshme të ketë edhe një përkushtim shtesë për këtë çështje, sidomos kur janë në pyetje çështja e kritereve të përzgjedhjes së kuadrove që do ta përfaqësojnë Kosovën në vendet tjera.

Duke iu adresuar kësaj nevojë, ne në këtë debat të sotëm pak a shumë nga këndvështrimet e ndryshme e gjithnjë qëllim mira si për kursin e qeverisë ashtu edhe për imazhin e gjithëmbarshtëm që do të duhej ta kishte shteti i ri i Kosovës, në periudhën që po hyjmë dhe në rrethanat në të cilat do të kultivohet ky imazh do të ishte mirë që përzgjedhja e përfaqësuesve tanë diplomatik në vendet ku qeveria vlerëson se duhet të dëgjohet zëri i Kosovës nëpër vende dhe institucione të rëndësishme vendimmarrëse botërore, të zgjedhë njerëz dhe kuadro që vërtetë e meritojnë. Ajo çka dua të them në fakt menjëherë, është se kriteri i përzgjedhjes nuk mendojë se do të duhej të ishin rekomandimet dhe propozimet që eventualisht do të mund të vinin apo edhe kanë filluar të vijnë nga diskursi e gjata monotone partiake e sidomos ato tribale, ashtu siç na informojnë disa medie tona. Për shkak se Kosova, në rast se dëshiron të dëshmojë unitet në këtë fazë përballë sfidave tjera të lartpërmendura dhe për hir të një kulture të re demokratike që duhet ta ndërtojë para faktorëve relevant dhe sidomos tash para EULEX-t, i cili do ta monitorojë çdo hap tonin në kuptimin e ndërtimit të këtyre

“standardeve” tjera të reja integruese, duhet të përfill kriteret profesionale, dijen, dhe mbi të gjitha aftësinë e përballjes me sfidat e reja të njohjes së Kosovës si shtet të ri në këtë pjesë të botës/

Pra, duke u nisur nga paradigma pragmatike politike, se bota e sotme është përfshirë nga proceset e reja integruese, apo kah tendencat e një diskursi të ri të identifikuar si proces i globalizimit, i cili në mënyrë të pashmangshme dhe të gjithanshme është duke i ndërruar jo vetëm raportet rajonale por edhe ato ndërkombëtare me synime shumëdimensionale dhe shumë dimensionale pra: zgjidhjen e problemeve kudo që shfaqen ato në botë, qofshin ato të natyrës së: mbrojtjes së drejtave të qytetarëve: problemeve globale ekologjike: eliminimit të varfërisë: zhvillimit të partneritetit global për emancipim të ri; politike, ekonomike e sidomos kulturor: përcaktimit të fuqishëm për proceset e reja integrative dhe të transicionit në rajonin e Evropës Juglindore në kuptimin: ekonomik; politik dhe atë të sigurisë: si edhe ndërtimin e një konfiguracioni të ri me dimensione të një prosperiteti në një rreth ane; ekonomik e në anën tjetër një varferie; poashtu ekonomike: *Ministria e Ardhshme e Punëve të Jashtme të Kosovës*, në përputhje me interesat e veta për ta instaluar demokracinë liberal demokratike, si edhe për ta fuqizuar rolin e qytetarit të ardhshëm të një Kosove demokratike, ku do të sundoje logjika e ligjit dhe fryma e një tregu dhe qarkullimi të lirë e në koherencë me interesat e veta si shtet i ri në hartën e

Evropës, *duhet të hartojë disa kritere dhe disa politika strategjike zhvillimore për periudhat që kërkojnë njohje dhe pranimin ndërkombëtar.*

Ne këtë kontekst , kujtojmë që Qeveria Thaçi dhe *Ministria e ardhshme Punëve të Jashtme*, e Republikës së Kosovës duke u bazuar në natyrën e momentit historik në të cilin aktualisht ajo gjendet tani pak kohë pas shpalljes së pavarësisë dhe pas njohjes së njëpasnjëshme të kësaj pavarësie dhe të këtij shteti, duhet sa më shpejt që përveç strategjisë së “seleksionimit dhe të identifikimit të kuadrove të reja për këto poste” , të hartojë në vija të trasha edhe politikat që shteti i Kosovës do t’i ndjek në planin e jashtëm. Së këndejmi, Qeveria jonë, që në fillim duhet t’i ketë parasysh dy rrethana që mendojmë për gjendjen tonë të gjithëmbarshme ekonomike dhe për procesin e veshtërsive që do hasim në këtë proces të njohjes dhe të këmbimit reciprok të përvojave me vendet tjera. Njëri është i natyrës materiale dhe tjetri i natyrës kadrovike. Duke u nisur nga një përvojë e vendeve që kanë dalë nga krahurat dhe burgjet e sistemeve koloniale dhe sidomos tyreve postkomuniste të Evropës Juglindore, themi se të gjitha këto shtete kanë hasur në këto dy vështirësi. Përvoja e këtyre vendeve, na tregon se natyra materiale disi është menduar të përballohet përmes reduktimit të numrit të stafit diplomatik si edhe të ministrive përkatëse. Një numër tjetër e shteteve duke dashur që sa më shumë të jetë në fokus të ngjarjeve botërore përdorë të gjitha mjetet vetëm e vetëm të ketë

një diplomaci të fortë. Të përmendi me këtë rast vetëm rastin e Ukrainës, p.sh. e cila me vite të tëra ka shit armë në mënyrë që të krijoj mjete për Ministrinë e sajë të Jashtme dhe stafin shtesë diplomatik nëpër botë. Një numër tjetër e shteteve për këtë qëllim nuk nguron të përdorë edhe emigracionin e vetë, e kështu me radhë. Me sa mund të përcillet përvoja e bollëkshme për këtë fah, kuptojmë që demokracitë e reja e kanë shumë më vështirë t’i mbajnë vijat e tyre diplomatike të hapura se sa bie fjala ato ish koloniale. Shteti i Kosovës, dallon padyshim me specifikat e veta edhe për një fakt që unë kujtojmë se është i njohur për të gjithë neve. E ai ka të bëjë me atë se: se gjersa të gjitha vendet postkomuniste që ishin me statusin e shtetit në cilindo federatë apo konfederatë që ishin, kishin aty këtu njerëz dhe stafë të shkolluar dhe të kalitur me zanatin e diplomacisë nëpër vendet e ndryshme të botës, Kosova nuk e ka pasur këtë mundësi. Dhe këtë luks, për arsye që i dimë të gjithë.

Kosova, në fakt çdo gjë është duke e filluar nga zeroja?! Dhe kjo është ajo pika kulmore dalluese që neve të gjithëve duhet të na bëjë më mobilizues në këtë drejtim. Por, duke marrë parasysh periudhën e pasluftës, gjykojmë që Kosova ka arritur të shkollojë kuadro bile të përfaqësues me proceset e reja që kemi hy jo vetëm si shoqëri por edhe si rajon.

Për vendet e vogla si është Kosova, kujtojmë që New Yorku do të duhej të ishte pika e parë referimit tonë të përbashkët, edhe për shkak se

New Yorku me pak mjete financiare do të mund të bënte shumë në procesin e rritjes së njohjes së Kosovës në botë, ashtu siç edhe ka bërë gjerë tani. Nuk duhet harruar që një numër i madh i shteteve të vogla e sidomos ato të reja siç jemi ne, në Kombet e Bashkuara në këtë kryeqytet botëror kisha me thënë, e shohin mundësinë e përfitimit të shërbimeve të ndryshme që ato nuk i kanë në vendet tjera, e që në fakt kanë shumë nevojë edhe për distribuimin e procesit të njohjes nëpër shtetet dhe vendet tjera të rëndësishme e edhe për shërbimet tjera shtesë që ofron kjo metropol tashmë botërore, duke filluar nga ato teknike, komunikuese, të përkthimeve, etj. mbledhjes së informatave, analizave etj.

Kahet dhe Planet afatshkurtra të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës

- Në përputhje me Kushtetutën që po hartohet *Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës*, për mendimin tonë duhet të jetë kompetente në udhëheqjen e Politikës së jashtme të Kosovës. Obligimet fundamentale të kësaj ministrie, do të duhej të ishin:

- Promovimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit të ardhshëm të Kosovës, në marrëdhëniet ndërkombëtare do të bazohen në paradigmat e Kushtetutës, ligjeve

dhe vendimeve që do të merren në koherencë me standardet që do aprovohen në Parlamentin e Kosovës.

- Përpjekja permanente dhe ndërtimi i aso raportesh për t'u pranuar veç e veç në suaza: ndërkombëtare, rajonale, bilaterale. Këto raporte shteti i ri i Kosovës duhet t'i rregulloj në varësi prej interesave të qytetarëve të sajë, pa dallim gjinie, kombi, race e etnie dhe në koherencë me aktet dhe ligjet e pranuar ndërkombëtarisht, siç janë: ato të KB, akti përfundimtar të Helsinkit dhe dokumentet tjera bazike të bashkëpunimit, sigurisë dhe të drejtat tjera ndërkombëtare

- Kjo politikë duhet të shquhet me një transparence publike dhe në barazi bilaterale me gjithë partnerët dhe miqët tanë rajonal dhe ndërkombëtar, pastajë me një respektim të dyanshëm në respektimin e sovranitetit dhe integritetit teritorial, si edhe në principet e bashkëpunimit dhe koegzistencës mes vendeve dhe shtetëve në proceset dhe parimet e integriteteve të reja Europiane.

- *Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës*, po ashtu duhet të përcaktohet kah hapja e pakushtëzuar dhe kah tejkalimi i të gjitha mosmarrveshjeve: politike, kulturore, ekonomike me gjuhën e dialogut dhe kompromisit demokratik, standard ku që është dëshmuar si mjaft profitabil në traditën dhe kulturën e Evropës.

- *Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës*, si institucion i ri i Kosovës në mënyrë shumë

pragmatike duhet të përkrah idetë dhe përcaktimet rajonale e ndërkombëtare për vazhdimin e luftës kundër terrorizmit dhe krimin të organizuar në koherencë me Rezolutat e Kombeve të Bashkuara dhe të Unionit Evropian.

• **Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës**, i takon në një të ardhme jo fort të largët ta hap pa hamendje edhe çështjen e suksesionit të ish trashëgimisë në ish federatën Jugosllave, sepse ishte pjese dhe kontribuuese e asaj krijese centaur.

(a) Kahet Bilaterale të Ministrisë së Punëve të Jashtme e Kosovës

• Meqenëse në parim Kosova, sipas **Ministrisë së Punëve të Jashtme e Kosovës**, do të duhej të ishte një Republikë bashkëkohore, ku Ministri përkatës të mund ta përfaqësojë në mënyrë të pakontestueshme shtetin e ri të Kosovës, ajo:

a. **do të duhej të angazhohet** në avancimin e marrëdhënieve: politike, ekonomike, kulturore, etj. me të gjithë fqinjët e sajë pa dallim: madhësie, përcaktimi ideologjik, politik, social, ekonomik, etj.

b. **do të duhej të fokusohet** në shtrirjen e një bashkëpunimi reciprok dhe në parime të njohura për eurokratët e Unionit Evropian, siq janë ato të: interesave të përbashkëta rajonale: respektimit të

ndërsjellë shtetëror: njohjes së sovranitetit dhe integritetit teritorial, etj.

c. **do të duhej të identifikohet** me normat dhe standardet e demokracisë neoliberales, ku qarkullimi i lirë i mallrave, njerzëve dhe kapitalit do të zhvillohet sipas marrëveshjeve të institucioneve ndërkombëtare

d. **do të duhej të përqendrohet** në avancimin e të drejtave të qytetarëve të sajë sipas normave dhe diskurseve më të avansuara të Unionit Evropian

• **Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës**, në parim do të duhej zhvillojë marrëdhënie bilaterale të posaqme me:

a. Shtetet anëtare të Komitetit Drejtues për respektimin e marrëveshjeve paqësore, siq janë; SHBA-t, Britania e Madhe, Franca, Kina, Rusia dhe shtetet tjera të Këshillit të Sigurimit pranë Kombeve të Bashkuara

b. Shtetet anëtare të Unionit Evropian,

c. Shtetet e reja rajonale të Ballkanit Perendimor (që përfshijnë plus Shqipërinë) duke përfshirë këtu padyshim edhe Kroacinë dhe Sllovenin, të cilat herë pas herë e kontestojnë këtë identitet

d. Shtetet tjera të cilat do ta njohin pamvarësinë e

Kosovës kudo në rruzullin tokësor

- Poashtu, sipas parimeve globale të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, duhet të insistojë në krijimin e parakushteve për një bashkëpunim dhe këmbim diplomatik, edhe me ato shtete të cilat eventualisht nuk do ta njohin pamvarësinë e Kosovës.

- Poashtu, *Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës*, duke u bazuar në parimet e demokracisë liberale një rëndësi të veçantë duhet t'i kushtojë bashkëpunimit me të gjitha vendet dhe shtetet të cilat janë të interesuara të investojnë në krijimin e parakushteve dhe kushteve tjera që kanë të bëjnë me hapjen e vendeve të reja të punës dhe të zhvillimit e avansimit të ekonomisë dhe të mirëqenies së qytetarëve të Kosovës si Republikë.

- *Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës*, në parim në planin diplomatik do të ishte e udhës që të stimulojë dhe inkurajojë të gjitha mundësitë zhvillimore që janë në interes strategjik të Kosovës.

- *Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës*, po ashtu do të duhej të inkurajojë në planin bilateral zhvillimin dhe avansimin e : shkencës, teknologjisë më të sofistikuar bashkëkohore, pastaj: arsimit bashkëkohor, sportit dhe

segmenteve tjera të rëndësishme për Kosovën.

Cilat prioritete duhet të fuqizojë *Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës*, në fazën e njohjes?

Parimet kryesore me të cilat do të duhej të udhëhiqej *Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës*:

a. *ruajtja* dhe avancimi i paqes dhe i stabilitetit rajonal

b. *sigurimi* dhe prosperiteti i stabilitetit ekonomik dhe ai i shtetësisë së Kosovës

c. *ndërtimi* dhe zgjerimi i kapaciteteve të inxhinieringut njerëzor lokal përmes projekteve; afatshkurtra; afatmesme dhe afatgjata

d. *kyçja* dhe dëshmimi pragmatik në trendet: (parasëgjithash) ekonomike, politike, e sidomos ato që kanë të bëjnë me sigurinë dhe stabilitetin rajonal të Ballkanit Perëndimor dhe atij European.

- Një parim principiell i *Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës*, padyshim që do të duhej të fuqizohet është ai që ka të bëjë me synimet vitale për shoqërinë e re demokratike Kosovare, siç janë:

1. Ruajtja e subjektivitetit politik të Kosovës deri në procesin e negocimit për integrim – asocim në formacionin e një Unioni Evropian.

2. Fuqizimi i sovranitetit dhe integritetit teritorial të Kosovës

3. Ndërtimi i kapaciteteve të *demokracisë ekonomike* si parakusht esencial për inaugurimin e *demokracisë politike*, sipas standardeve të UE-an

4. Kycja e Kosovës në strukturat Euro Atlantike

5. Anëtarësimi i plotë i Kosovës në aktivitetet globale që ndërlidhen me sistemet globale botërore, sic janë; Kombet e Bashkuara(KB); Këshilli i Sigurimit (KS); Keshilli i Europës; Organizata për Siguri dhe bashkëpunim në Europë (OSBE-ja), etj.

Cilat duhet të jenë Kahet multilaterale të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës?

- Kosova e gjendur një konfiguracion shumë të rëndësishëm; demografik, gjeografik, e strategjik, në Ballkanin Perëndimor me siguri që në diskursin gjeostrategjik do të luaj një rol shumë domethënës dhe kuptimplotë në kontekstin e zhvillimit të politikave (parasëgjithash); ekonomike, politike, e sidomos kulturore.

- Së këndejmi, **Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës**, duhet të parash që pozita e këtyre gjeostrategjike e Kosovës, në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër të

mund të loz një rol goxha të rëndësishëm në proceset e ardhshme integruese edhe me faktin, se: Kosova do jetë urë ndërlidhëse edhe në periudhat e ardhshme mes civilizimit: jug Lindor dhe atij perëndimor.

- **Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës**, do të duhej të rekomandon fuqizimin e synimeve që kanë të bëjnë me aspektet e defilimit të jashtëm politik; krijimin e parakushteve për një demonstrim të vlerave tipike të demokracisë neoliberale, sidomos në fazën post statusore apo atë të 120 ditëshit post statusor.

- **Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës**, duhet të fillojë që tani të institucionalizojë raportet me Unionin Evropian, për shkak se ai edhe ashtu do t'i monitorojnë institucionet e Kosovës deri në fillimin e procesit asociativ të Kosovës në mekanizmat Evropian.

- Për **Ministrinë e Punëve të Jashtme e Kosovës**, fillimi i procesit të asociativit me mekanizmat e Unionit Evropian do të duhej të ishte i një rëndësie të veçantë nacionale, sikurse ai i anëtarësimit të saj në Organizatën ndërkombëtare të Tregëtisë(WTO), në mënyrë që të kanalizohen rruget për kyçjen e Kosovës në trendet tjera globale tregëtare.

- Fuqizimi i **Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës**, me Organizatën tjetër të rëndësishme siç është ajo e Sigurisë dhe bashkëpunimit për Siguri në Evropë (OSBE-n), do të ishte një hap tjetër

inkurajues. Ku menjehere do te afatizoheshin ndertimi i objektivave per bashkepunim rajonal (neni II dhe ai V i Aneksit 1-B), si edhe synimin e Kosoves për t'u kyçur në biseda për kontrollin rajonal te armatimit (neni V i po te njejtit Aneks);

- Synimi per tu anetaresuar ne institucionet veri atlantike, poashtu do te duhej të behej një prioritet afatgjatë i **Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës**, vetëm e vetëm që këto raporte të ngritën ne nivel te institucionalizimit te mirefillet dhe me qellim te marrjes se obligimeve te ndersjellta dhe të Partneritetit për Paqe.

- Duke i pasur parasysh gjithenje interesat vitale kombetare te Republikës së Kosovës, **Ministria e Jashtme e Kosovës**, duhet të ketë imperativ vëmendjen në konkretizimin marrëdhënive te reja me mekanizmat tjere poashtu shume relevant dhe dobiprurëse për interesat e Kosoves, siq janë;

a. Iniciativat e reja te Europes Qendrore (CEI)

b. Iniciativat per bashkepunim rajonal te Europes Juglindore(SEECP)

c. Paktin e Stabilitetit

d. Iniciativen e Adriatikut per bashkepunim

e. Dhe iniciativat tjera te reja rajonale e nenrajonale te domeneve evrolindore

- Gjithashtu një vëmendje të posaçme, për mendimin tonë **Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës**, do duhej t'i kushtonte sidomos diasporës Kosovare, e në veçanti spektrit te interesave te kesaje branshe bashkëqytetarësh te cilit per mendimin tone duhet të jenë një shtyllë e rëndësishme e Projektit për rindërtimin e Kosovës ne fazat e investimeve të mëdha që priten të vijnë pas sfidave të sigurisë dhe stabilitetit rajonal.